

LIGJ
Nr.7617, datë 6.10.1992

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KOMUNITETIT EKONOMIK EVROPIAN PËR TREGTINË DHE BASHKËPUNIMIN
TREGTAR DHE EKONOMIK"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Ekonomik Evropian për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar Ekonomik", që u nënshkrua në Bruksel më 11 maj 1992.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekreten nr.321, datë 13.10.1992, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.